



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH

Numri i lëndës: 2022:002784

Datë: 04.08.2022

Numri i dokumentit: 03299464

**P.nr 1/22**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM DIVIZIONI PENAL**, nga gjyqtari Sabaheta Kurteshi, me bashkëpunëtorin profesional Arlind Rifaj, në lëndën penale kundër të akuzuarit **A. B.** nga fshati..., Komuna e Dragashit, tani me vendbanim në Gjermani, me numer personal..., i akuzuar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Prizren PP/II.nr.1734-13/19 të dt. 09.10.2019, për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 185. par. 1, lidhur me paragrafin.31, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës Nr.06/L-074 KPRK) në prezencën e të akuzuarit si dhe përfaqësuesit të Prokurorisë Themelore në Prizren – Prokurori i Shtetit, Musli Gashi, më datë 18.07.2022 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 04.08.2022 përpiloi, këtë:

**A K T G J Y K I M**

**Ndaj të akuzuarit:**

**A. B.**, i lindur me dt..., në fsh..., Komuna e Dragashit, nga i ati Z., e ëma A., e gjinisë H., i pa martuar, student, me përkatësi Kombëtare Goran, Shtetas i Republikës së Kosovës.

**ËSHTË FAJTOR**

Se me dt. 06.08.2019, rreth orës 00:00 në fshatin..., Komuna e Dragashit, saktësisht në qendër të fshatit, derisa i dëmtuari ishte ulur në një mur duke dëgjuar muzikë, pas një fjalosje paraprake me të pandehurit për shkak të një mosmarrëveshje të mëhershme që kishte me ta, i akuzuari A. R. e kishte kapur për dore duke ja pamundësuar lëvizjen, ndërsa i akuzuari A. B. e kishte sulmuar fizikisht duke e goditur fillimisht me grushte pastaj e kishte goditur me një shishe të ujit mineral në kokë, me çka të dëmtuarit J. K. i kanë shkaktuar lëndim në formë të plagës qarëse-shqyese të indeve të buta të regjionit të laprës së veshit të majtë, të shkaktuara nga veprimi mekanik i mjetit të fortë mbretës (jo i mprehtë, i topitur) që si të tilla bëjnë pjesë në dëmtime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin, lëndime këto të përshkruara në mendimin e ekspertit mjeko ligjor Dr. F. D., të datës 19.09.202019.

**- Këso dore në bashkëkryerje ka kryer veprën penale lëndimi i lehtë trupor nga neni . 185. par. 1. lidhur me nenin 31 të Kodit nr.06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës.**

Andaj, gjykata në mbështetje të nenit 2,4,6,39, 40, 43,69,70,71 të KPRK-së dhe nenit 184 par.1 KPRK-es lidhur me nenin 365. të KPP-së, të akuzuarit i shqiptohet:

## DËNIMI ME GJOBË

Në shumë prej 250,00 (dyqind e pesëdhjetë euro) €, të cilin dënim do ta paguaj përmes llogarisë rrjedhëse të kësaj gjykate, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi, poqëse dënimin me gjobë i akuzuari nuk e paguan në afatin e caktuar i njëjti dënim me këtë Aktgjykim zëvendësohet me dënim me burgim dhe atë prej nga 13 ditëve burg, duke llogaritur 20,00 €, në një ditë burgu .

I dëmtuari J. K., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontestin e rregullt civil.

I akuzuari **OBLIGOHET** që të paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës penale sa ato të bëhen dhe atë në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumë prej 50,00 € , si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave shumë prej 30,00 euro ,në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi, nën kërcënimin të ekzekutimit të dhunshëm.

## A r s y e t i m

### Pretendimet e palëve

Prokuroria themelore ne Prizren pranë kësaj gjykate ka parashtruar aktakuzën PP/II.nr. 1734-13/2019 të dt. 09.10.2019, **kundër të akuzuarve A. B., nga fshati..., komuna e Dragashit dhe A. B., nga fshati..., Komuna e Dragashit** për shkak se ne bashkëkryerje kane kryer veprën penale lëndimi i lehtë trupor, nga neni 185 par.1 lidhur me nenin 31 te Kodit Penal te Republikës se Kosovës Kodi nr 06/L-074 (KPRK-es ).

Gjyqtarja e vetme gjykuese duke vepruar në këtë çështje penale në bazë të nenit 242 par.5 të KPPK-ës, ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 18.07. 2022, në prezencën e prokurorit të shtetit Musli Gash si dhe të akuzuarit A. B.

Gjyqtarja e vetme gjykuese pasi ka udhëzuar të akuzuarin në bazë të nenit 246 par.1 të KPP-ës dhe pasi prokurori i shtetit ka lexuar aktin akuzues dhe pasi gjyqtarja u bind se i njëjti e ka kuptuar aktakuzën, në bazë të nenit 246 par. 4 si dhe pas njoftimit sipas dispozitave të neneve 325 dhe 327 te KPP-es, të njëjtit i ofroj mundësinë të pranojë fajësinë ose të deklarohet i pafajshëm.

### Pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit

I akuzuari me rastin e deklaramit lidhur me fajësinë apo pafajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar, në shqyrtimin fillestar ka theksuar se e ndien veten fajtor dhe e pranon fajësinë sipas të gjitha pikave të aktakuzës, pranimin e kanë bërë në mënyrë vullnetare duke qenë i vetëdijshëm për pasojat që mund të vijnë si rezultat i pranimit të fajësisë, duke shtuar se është penduar për kryerjen e veprës penale me te cilën ngarkohet, dhe se me të dëmtuarin është pajtuar që nga viti 2019.

Pasi që i akuzuari e ka pranuar fajësinë në shqyrtimin fillestar, gjyqtarja e vetme gjykuese duke vepruar në pajtim me nenin 248 par.2 të KPPK-së, ka kërkuar edhe mendimin e prokurorit të shtetit. Prokurori i Shtetit, me rastin e paraqitjes së mendimit lidhur me pranimin e fajësisë nga akuzuarit ka deklaruar se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, pasi pranimi fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare dhe në përputhje me dispozitat ligjore të nenit 248 të KPRK-së si dhe provat materiale dhe faktet e çështjes, prandaj i propozoi gjykatës që të njëjtën ta shpallë fajtor dhe t'i shqiptojë sanksion penal në pajtim me ligjin.

### **Vlerësimi i pranimit të fajësisë**

Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë shqyrtoi me kujdes kushtet e parapara nga neni 248 par. 1 të KPPK-së dhe me këtë rast vlerësoi se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht, pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret si dhe materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit, dhe në provat tjera të cilat gjinden në shkresën e lëndës, sepse i akuzuari prej fillimit të procedurës kundër tij e gjate shqyrtimit fillestar, ka qenë i njoftuar me të gjitha provat që gjinden në shkresat lëndës si: kallëzimi penal, raportit të oficerëve të policisë, deklaratës se të dëmtuarit, raportit mjekësor të lëshuar nga Spitali Regjional Daut Mustafa në Prizren për të dëmtuarin J. K. Me qenëse i akuzuari e ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, gjyqtari në bazë të nenit 248 paragrafit 4 të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit. Gjykata po ashtu vërtetoi se prokurori ka disponuar me prova të mjaftueshme për veprën penale të akuzuarit dhe ka dhënë mendimin për pranimin e fajësisë nga ana e tij. Gjykata vërtetoi përtej çdo dyshimi se në veprimet e të akuzuarit A. B. ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale, lëndim i lehtë trupor, nga neni 185 par.1 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës Kodi Nr. 06/L-074 (KPRK) meqë me datë, vend dhe kohë siç është përshkruar hollësisht në dispozitiv të këtij aktgjykimi saktësisht në qendër të fshatit Restelicë, për shkak të një mosmarrëveshje të mëhershme me të dëmtuarin J. K., i akuzuari A. B. të njëjtin fillimisht e godet me grushte e me pas e godet me një shishe të ujit mineral në kokë me çka i shkaktonte lëndim në formë të plagës çarëse, ku si pasojë e të cilave i dëmtuari ka kërkuar trajnim mjekësor fillimisht në QKMF Dragash e më pas në Spitalin Regjional Daut Mustafa në Prizren, andaj i njëjti është penalisht përgjegjës dhe është shpallur fajtorë për veprën penale që i ngarkohet.

### **BAZA LIGJORE**

Gjykata gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara si në nenin 69,70,71,72 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në zgjidhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit. **Gjykata si rrethanë lehtësuese ka vlerësuar se në gjykatë i akuzuari ka pasur qëndrim tejet korrekt, pranimin e fajësisë për veprën penale që i ngarkohet, faktin se më parë nuk ka qenë i dënuar për veprën penale, rrethanat tjera në momentin e kryerjes së veprës penale, pendimin, pajtimin me të dëmtuarin dhe kërkimfaljen ndaj të dëmtuarit,** prandaj gjykata ka ardhur në përfundim se me këtë lloji të dënimit të shqiptuar, është e bindur se ndaj të akuzuarit do të arrihet efekti i sanksionit të paraparë sipas KPRK-së. Mbi bazën e këtyre rrethanave, gjykata është e bindur se dënimi i shqiptuar është në harmoni me peshën e veprës penale dhe përgjegjësinë penale të të akuzuarit dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë. Duke marrë parasysh edhe faktin se i njëjti ka bërë pranimin e fajësisë dhe duke vlerësuar se edhe me dënim me gjobë do të arrihet qëllimi i dënimit, e cila është bërë në seancën e shqyrtimit fillestar, me

bindje se do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimit, të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 38 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK) 06/L-074, përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë veprës penale dhe kryesit që do të shërbej në parandalimin të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë dhe do të arrihet qëllimi që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale.

Vendimi lidhur me kërkesën pasurore-juridike është marr në kuptim të nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPP-së, pasi që nga të dhënat e mbledhura gjatë zhvillimit të procedurës nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërisht.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës gjyqësore dhe atë ne emër te paushallit gjyqësor u murrën në kuptim të nenit 450 par. 2 nën par. 2.6 të KPPK-së, ndërsa për kompensimin e viktimave të krimit është marrë në bazë të nenit 39 par. 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 05/L-036, për kompensimin e viktimave të krimit. Në bazë të theksuarës më lartë u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi .

Në bazë të të thënave më lartë u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL**

**2022:002784, 04.08.2022**

**G j y q t a r i**

---

**Sabaheta Kurteshi**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.